



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.123/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në kontestin tregtar - administrativ, të paditësit “Zh...” sh.p.k, me seli në Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë V.Zh dhe M.M, Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike - anulim vendimi, objekt kontesti - rivlerësim malli, vlerë kontesti 8,615.25 EUR në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të mbajtur me datë 27.10.2022, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Avokat V.Zh, dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur B.S, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Zh...” sh.p.k, me seli në Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë V.Zh dhe M.M, Avokat në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.01.3.2.2/9843 i datës 23.09.2020 i Doganës së Kosovës dhe lënda KTHEHET NË RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A R S Y E T I M

Paditësi “Zh...” sh.p.k, me seli në Podujevë, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 27.08.2020, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, fillimisht kundër aktvendimit 01.3.2.2/8309 dhe 8310 të datës 16.07.2020, ndërsa me parashtresën e datës 28.09.2022 e ka precizuar kërkesëpadinë në kuptimin objektiv duke i propozuar gjykatës të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Zh...” sh.p.k, me seli në Podujevë, dhe të anulohet aktvendimi i Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/9843 i datës 23.09.2020, si dhe të detyrohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësit t’ia kthej shumën prej 4,546.62 € të paguar më tepër në

emër të detyrimeve doganore për mallin e importuar përmes DUD R-2770 të datës 14.03.2020 të ZBD Merdare, dhe shumën prej 4,248.63 €, të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore për mallin e importuar përmes DUD R-2774 të datës 14.03.2020 të ZBD Merdare, në shumën e përgjithshme prej 8,795.25 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaron se : ne si palë paditëse kemi paraqitur të gjithë dokumentacionin dhe provat ku kemi vërtetuar se çmimi i faturës dhe urdhërpagesa ndërkombëtare përputhet në tërësi, dhe vlera e çmimit të faturës është vlerë e saktë. Po ashtu, gjatë zhdoganimit paditësi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin përkatës i cili kërkohet në bazë të UA nr.11/2009. Andaj, pretendimet e paraqitura nga pala e paditur janë në tërësi kontradiktore, për faktin se e paditura nuk ka arritur që të vërtetojë dhe as të arsyetojë se për çfarë arsye nuk i ka pranuar dokumentet të cilat janë paraqitur nga paditësi gjatë procesit të zhdoganimit të mallit lëndor. Sa i përket vlerës së kontestit, gjatë kalkulimit kam parë se kam bërë një gabim teknik, andaj, bëjë precizimin e kërkesëpadsisë sa i përket vlerës së kontestit, ashtu që kjo vlerë duhet të jetë 8,615.25 €. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 03.10.2022 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marr komfor të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Po ashtu, e paditura ka theksuar se e njëjta i ka trajtuar pretendimet e paraqitura në seancën e datës 27.09.2022, duke deklaruar se këto pretendime janë paraqitur edhe në fazën e ankimit në Doganën e Kosovës dhe janë trajtuar në aktvendimin kontestues një nga një dhe të gjitha së bashku, dhe pikërisht për faktin se nga paditësi nuk është paraqitur dokumentacioni i mjaftueshëm dhe i harmonizuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e paguar për mallin lëndor kontestues, është bërë rivlerësimi i mallit, meqenëse fatura dhe transferet bankare nuk janë të harmonizuara.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaron se : Paditësi me rastin e deklarimit të mallit është konstatuar se

ka deklaruar vlerë më të ulët se sa vlera reale e mallit, bazuar në të dhënat e disponueshme të Doganës së Kosovës, të përdorura në frymën e nenit 35 të KDA-së që në rastin konkret janë të dhëna të nxjerra nga aplikacioni trectek që pasqyron vlerën reale të mallit. Deri tek kontestimi i vlerës ka ardhur pasi që paditësi nuk ka arritur që përmend dokumentacionit ta bind Doganën e Kosovës që vlera e deklaruar paraqet vlerën e paguar apo të pagueshme për mallin lëndor kontestues. Fatura dhe transferi bankar i prezantuar nga paditësi nuk janë të harmonizuara me njëra tjetrën, pasi që paditësi për DUD-in R-2770 ka prezantuar faturën nr. ... si dhe transferin bankar të datës 03.03.2020, kurse në përshkrimin e transferit bankar është evidentuar pagesë për pro faturën ..., e që në rastin konkret kjo pro faturë asnjëherë nuk i është prezantuar Doganës së Kosovës, e as në shkresat e lëndës nuk është evidentuar deri në këtë fazë të procedurës. Po ashtu, për DUD-in R-2774 të datës 14.03.2020, në shkresat e lëndës është bashkangjitur fatura nr. ... si dhe transferi bankar që përmban përshkrimin pagesë për pro faturën ..., kurse kjo pro faturë fare nuk është bashkangjitur as në fazën e deklarimit të mallit, e as deri më tani në shkresat e lëndës. Po ashtu sa i përket Deklaratës Eksportuese të bashkangjitur nga paditësi është evidente se kjo deklaratë nuk përmban vulën e autoritetit doganor të shtetit eksportues për ta bërë këtë dokument të besueshëm, si dhe nuk përmban të dhënat mbi vlerën e mallit që zakonisht vendoset në Deklaratat Eksportuese. Rrjedhimisht mbi bazën e këtyre mos përputhjeve dhe të dhënave të pa mjaftueshme të prezantuara nga paditësi, Dogana e Kosovës ka vlerësuar mallin konform nenit 35 të KDA-së, meqenëse është konstatuar se paditësi ka deklaruar vlerën më të ulët se sa vlera reale e paguar apo e pagueshme për mallin lëndor kontestues. Po ashtu, më lejoni të konfirmoj se kërkesa e paditësit për kthimin e mjeteve të paguara më tepër sipas parashtrësës së datës 28.09.2022 në shumë prej 8,795.25 € për dy DUD-at kontestues është e pa saktë, pasi që pas analizës që i kemi bërë këtyre DUD-ave në sistemin ASYCUDA kemi vërejtur se vlera që paditësi ka paguar si ndryshim prej vlerës së deklaruar dhe vlerës së rivlerësuar është 8,615.25 €. Po ashtu, përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës ka theksuar se paditësi edhe në këtë seancë nuk arriti të prezantoj pro faturat në emër të të cilave është bërë pagesa e mallit. Ndërsa tani pas precizimit të bërë në këtë seancë lidhur me vlerën e kontestit të njëjtën nuk e kundërshtoj. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimet nr.9843/23.09.2020, nr.8309 dhe 8310/16.07.2020, Përgjigjet në Padi të

datës 08.10.2021 dhe 03.10.2022, Proceset mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave të datës 14.03.2020, Fotografitë me të dhëna nga faqja e internetit trectek.io, Kërkesat për Rishqyrtim të ushtruara në Doganën e Kosovës nr.8309/09.07.2020, nr.8310/09.07.2020, DUD-at R-2770/14.03.2020, R-2774/14.03.2020, Deklaratat EXA, e-mail-at e datës 09.07.2020, Librezat e Mjeteve Autobus, Urdhërpagesat Ndërkombëtare të realizuara në Bankën NLB në vlerë prej 65,000.00 € datë 03.03.2020 dhe në vlerë prej 80,000.00 € datë 03.03.2020, Faturat nr. ..., ..., si dhe EU1 nr.833558, nr.833557,

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga DUD-at kontestues të Doganës së Kosovës, deklarimeve në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi ka paraqitur DUD-at R-2770 të datës 14.03.2020, dhe R-2774 të datës 14.03.2020, për zhdoganim pranë ZBD Merdare, me ç'rast të njëjtit janë proceduar, duke u ri-vlerësuar bazuar në metodën e 6-të. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 23.09.2020, ka sjell Aktvendimin nr. 01.3.2.2/9843 si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin është refuzuar kërkesat e subjekti në procedurë lidhur me shqyrtimin e vendimeve R-2770/14.03.2020 dhe R-2774/14.03.2020, dhe ka lënë në fuqi rivlerësimet e Sektorit të pranimit Qendror, e kundër të cilit paditësi me padinë e datës 27.08.2020, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore R-2770 të datës 14.03.2020, dhe R-2774 të datës 14.03.2020 të ZBD Merdare. E paditura ka vlerësuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur e ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e

mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Tutje theksohet se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme, pasi që në shkresat e lëndës mungon Kontrata e Shitblerjes dhe Deklarata Eksportuese e shtetit eksportues. Pastaj se Dogana e Kosovës disponon me të dhëna tjera dhe se subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale të mallit lëndor kontestues, andaj, në bazë të këtyre ndryshimeve, përkatësisht karakteristikave të ngjashme të mallit është përcaktuar edhe çmimi për mallin lëndor. Prandaj, në këtë kuptim Dogana e Kosovës nuk mund të bëjë konstatim tjetër të gjendjes faktike nga gjendja dhe çmimi i përcaktuar nga Zyra Doganore.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, te metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna te pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket rivlerësimit të mallit lëndor. Në arsyetimin kontestues nuk është dhënë arsyetim i bazuar, përse nuk është pranuar vlera e transaksionit, kur paditësi ka prezantuar dokumentacionin valid që dëshmon për çmimin e paguar, dhe nuk është dhënë asnjë provë për tu dëshmuar se paditësi i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturës së mallit, për të dëshmuar konstatimin e dhënë se vlerës së mallit të deklaruar për zhdoganim nuk duhet t'i pranohet vlera e transaksionit.

Mos vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, Gjykata e konsideron faktin se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike-administrative. Në arsyetim të vendimit kontestues, thuhet se Sektori e Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë, në vështrim të nenit 33, të KDA-së, mirëpo një konstatim i tillë për Gjykatën është tërësisht i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur në prova materiale, është shumë kontradiktor në vetvete dhe në raport me dokumentacionin e prezantuar, si dhe me bazën ligjore në fuqi, dhe sepse e paditura nuk ka qenë të gjendje të provojë këtë konstatim, kjo edhe përmes ndonjë dëshmie me

të cilin do të argumentohej se paditësi nuk i ka paguar eksportuesit përmes transaksionit bankar çmimin e faturave apo se i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturave blerëse të mallit.

Gjykata ka shqyrtuar vendimin kontestuese dhe pretendimet e paditësit lidhur me mospranimin e vlerës së mallit, duke konstatuar se paditësi ka provuar që me prova bindëse të dëshmoj para Doganës që në kuptim të dokumenteve përcjellëse të prezantuara, paditësi në këtë rast ka prezantuar Urdhërpagesat Ndërkombëtare të realizuar në Bankën NLB në vlerë prej 65,000.00 € e datës 03.03.2020, dhe në vlerë prej 80,000.00 € e datës 03.03.2020, dhe të cilat janë të harmonizuara në tërësi në kuptim të vlerës dhe të përshkrimit me faturën Faturat nr. ... të datës 12.03.2020 dhe nr. ... të datës 12.03.2020. Gjykata vlerëson se legjislacioni doganor nuk përmban dispozita ku thuhet se vlera doganore e mallrave të importuara, duhet të jetë në përputhje me vlerën e të dhënave të disponueshme nga Dogana e Kosovës, në rastet kur ka dokumentacion përcjellës të harmonizuar, por përkundrazi tek neni 33 par.1 të KDA-së është parashikuar se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*.

Gjykata e obligon të paditurën se në rishqyrtim dhe rivendosje, duhet të konstatoj këto pretendime të cekura si më lartë dhe argumentet e paditësit dhe të deklarojë lidhur me provat e administruara përkatësisht Urdhërpagesat Ndërkombëtare të realizuar në Bankën NLB të datës 03.03.2020, dhe të cilat janë të harmonizuara në tërësi në kuptim të vlerës dhe të përshkrimit me faturat nr. ... të datës 12.03.2020 dhe nr. ... të datës 12.03.2020. Në arsyetimin e vendimit kontestues shihet se e paditura nuk ka shqyrtuar drejtë pretendimet e paditësit për të konstatuar se faturat dhe dokumentet tjera përcjellëse përse janë kontestuar, pra nuk janë marr për bazë dhe nuk i kanë pranuar si valide, andaj një akt administrativ i tillë nuk përmban një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata.

Tutje e paditura nuk është deklaruar fare lidhur me deklaratën eksportuese të mallit kur dihet se e njëjta ka qenë të bashkangjitur DUD-it kontestues në procedurë të zhdoganimit të mallit, dhe se e njëjta përmban të dhëna lidhur me mallin, eksportuesin,

importuesin, origjinën, peshën neto dhe bruto, dhe të dhëna të tjera. E paditura nuk është deklaruar fare as lidhur me provat në të cilat është bazuar respektivisht në të dhënat e disponueshme, apo aplikacionit “...” siç është referuar, janë mallra që kanë të bëjnë me përshkrim-malli identik apo të ngjashëm me mallin lëndor kontestues, se janë nga i njëjti shtet eksportues, me kod tarifor identik, origjinë të njëjtë, sasi të njëjtë apo të përafërt, në mënyrë që të mund të zbatohen në rivlerësimin e mallit të zhdoganuar me DUD-at R-2770 të datës 14.03.2020, dhe R-2774 të datës 14.03.2020 të ZBD Merdare.

Të metat e mësipërme janë të asaj natyre që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj aktvendimi i atakuar u dashtë që doemos të anulohet, tutje Gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të deklarohet lidhur me provat e paraqitura nga paditësi lidhur me Deklaratat Unike Doganore R-2770 të datës 14.03.2020, dhe R-2774 të datës 14.03.2020 të ZBD Merdare, dhe të administruar nga Gjykata e të cilat u përmenden më lartë.

Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri, e paditura të vlerësoj drejtë gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit të deklarohet lidhur me të dhënat e aplikuara me rastin e rivlerësimit të mallit kontestues dhe të aplikoj drejt dispozitat ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallrave. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vendimi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 2, e 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.123/22 datë 27.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional
Visar GASHI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.